

Indeksi i cenueshmërisë ndaj dezinformimit në Kosovë

Indeksi i
cenueshmërisë
ndaj
dezinformimit
në Kosovë



**INDEKSI I CENUESHMËRISË
NDAJ DEZINFORMIMIT NË
KOSOVË**

AUTORE:


Dr.Albana Rexha

Analiste e lartë e politikave, Democracy Plus

KONSULENT METODOLOGJIK:


Morgan Wack, PhD Candidate

Universiteti i Uashingtonit

 Visit our website
www.dplus.org

Zbuloni më shumë për publikimin tonë të fundit,
lajmet, infografikat online.

 Na gjeni në Facebook
[@democracyplus](https://www.facebook.com/democracyplus)

 Na gjeni në LinkedIn
[@democracy-plus](https://www.linkedin.com/company/democracy-plus)

 Na gjeni në Twitter
[@democracy_plus](https://twitter.com/democracy_plus)

 Na gjeni në Youtube
[@Democracy.Plus](https://www.youtube.com/Democracy.Plus)

Zyrat tona:

Rruga Bajram Kelmendi, Nr.92, Kati V
Prishtinë, 10000
Kosovë

+383 (0) 38 749 288
info@dplus.org

Ky raport është publikuar nga Demokraci Plus (D+) në kuadër të projektit “Indeksi i cënueshmerisë nga dezinformatat”, që mbështetet nga Instituti Kombëtar Demokratik - NDI dhe Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar - USAID. Përmbajtja e këtij raporti i përket Demokraci Plus dhe jodomosdoshmërisht pasqyron qëndrimin e NDI dhe USAID.

Përmbledhje

06

Gjetjet lidhur me
domenin e mjedisit
mediatik:

08

Gjetjet lidhur me
domenin e peizazhit
politik:

09

Gjetjet lidhur
me domenin e
perceptimit publik:

10

Implikimet për
ndryshimet e
politikave

11

Sfidat e integritetit
të informacionit në
Kosovë

18

ANEKSI I
Konceptet kryesore

22

ANEKSI II
Metodologjia – Burimet
gjithëpërfshirëse të
informacionit

23

ANEKSI III
Libri i kodeve

30

ANEKSI V
Lista e intervistave
me ekspertët

42



“Zgjidhja e problemit të dezinformimit nuk do të kurojë të gjitha lëngatat e demokracive tona apo të mbyllë çarjet në strukturën e botës sonë, por mund të ndihmojë në zbehjen e ndasive dhe të na lejojë të rindërtojmë besimin dhe solidaritetin e nevojshëm për ta bërë demokracinë tonë më të fortë.”

— Ish-presidenti i SHBA-së, Barack Obama
21 prill 2022

Përmbledhje

Dezinformimi është një kërcënim madhor për demokracinë dhe sigurinë kombëtare të Kosovës. Ndikimi malinj i huaj, mungesa e edukimit mediatik dhe polarizimi i ngjarjeve politike dhe zgjedhjeve dobësojnë qasjen e qytetarëve në informacion, duke minuar aftësinë e tyre për të marrë vendime të informuara. Përhapja e shpejtë e dezinformimit/keqinformimit mund të shkaktojë dhunë dhe rritje të tensioneve me Serbinë.

Për të kuptuar më mirë kërcënimet ndaj integritetit të informacionit në Kosovë, Demokraci Plus krijoi këtë Indeks të Cenueshmërisë ndaj Dezinformimit në Kosovë (në tekstin e mëtejshëm, Indeksi) për periudhën dhjetor 2021–nëntor 2022. Ai vlerëson cenueshmërinë e Kosovës ndaj çrregullimeve të informacionit në një shkallë të matshme. Indeksi ofron vlerësim të përgjithshëm të situatës aktuale dhe mundëson krijimin e hartës së

faktorëve të tjerë kyç të përfshirë, ndërkohë që ofron vlerësim bazë gjithëpërfshirës të nivelit të cenueshmërisë.

Qëllimi i Indeksit është të kuptohet në thellësi dinamika në vijimësi e hapësirës informative mediatike të Kosovës dhe qëndrimet e kosovarëve ndaj çrregullimeve të informacionit dhe ndikimit malinj të huaj. Për më tepër, ky Indeks synon të ofrojë pasqyrë gjithëpërfshirëse të masave që duhet të implementohen nga institucionet vendimmarrëse për të zbutur kërcënimet ndaj mjedisit informativ të Kosovës.

Indeksi vlerëson tri domene kryesore: 1. mjedisin mediatik, 2. peizazhin politik, dhe 3. perceptimet publike. Domenet kyçe janë vlerësuar nga perspektiva e ndikimit malinj të huaj në Kosovë. Këto domene u përzgjedhën për të shqyrtuar

situatën aktuale dhe për të hartuar faktorë të tjerë të rëndësishëm. Në vitet e ardhshme, Indeksi do të zgjerohet për të përfshirë domene të tjera që janë ose mund të jenë të cenueshme ndaj dezinformimit.

Përfaqësimi sasior i cenueshmërive në secilin domen ofron perspektivë gjithëpërfshirëse mbi nivelin e cenueshmërisë për secilin domen dhe mundëson krahasimin e tyre. Janë përdorur shtatë burime gjithëpërfshirëse të informacionit (shih Aneksi II). Të gjitha burimet janë përshtatur për të pasqyruar shkallën 0-100, sa më afër 100 aq më e madhe cenueshmëria. Duke përdorur R software, secila variabël është rishkallëzuar në mënyrë që rezultatet të llogariten nga totali prej 100. Domenet ndahen në tri kategori: më pak i cenueshëm (0-33.3), i cenueshëm (33.4–66.6) dhe më i cenueshëm (66.7-100).




Indeksi gjeti se mjedisi mediatik dhe peizazhi politik i Kosovës janë më të cenueshëm ndaj dezinformimit dhe ndikimeve malinje të huaja se sa domeni i perceptimit publik:



1 Gjetjet lidhur me domenin e mjedisit mediatic:

Indeksi zbulon se mjedisi mediatic është i cenueshëm ndaj dezinformimit dhe ndikimeve malinje të huaja, duke shënuar 46 pikë nga 100 të mundshme, më i cenueshmi ndër tri domenet e Indeksit.



Sfidat përfshijnë kapacitetin e institucioneve për të menaxhuar dezinformimin duke përfshirë mediat dhe rolin e Facebook-ut, si dhe reziliencën e publikut ndaj keqinformimit dhe dezinformimit. Kapaciteti i institucioneve, në veçanti i mediave, për të menaxhuar kërcënimin nga dezinformimi është i cenueshëm. Në mënyrë të


ngjashme, efektiviteti i Facebook-ut për të kontrolluar dezinformimin konsiderohet i dobët/inekzistent, kryesisht për shkak të mungesës së një partneri për verifikimin e fakteve në Kosovë, deri së voni. Dezinformimi konsiderohet kërcënim më serioz në hapësirën digjitale në krahasim me mediat tradicionale, duke përfshirë kanalet televizive

Gjithsej pikë

46
/100

2 Gjetjet lidhur me domenin e peizazhit politik:

Indeksi zbulon se peizazhi politik është i cenueshëm ndaj dezinformimit dhe ndikimeve malinje të huaja, duke shënuar 45 pikë nga 100 të mundshme. Ky domen kap qëndrimet dhe sjelljet e udhëheqësve institucionalë (presidentes, kryetarit të kuvendit dhe kryeministrit), kapacitetin institucional, cenueshmërinë gjatë politikës së përditshme dhe zgjedhjeve, si dhe kapacitetin institucional për të menaxhuar dezinformimin e huaj.



Ndonëse të cenueshme, qëndrimet dhe sjellja e liderëve politikë janë pak më pak të cenueshme sesa kapaciteti institucional për të menaxhuar dezinformimin e huaj dhe cenueshmëria gjatë zgjedhjeve dhe politikës së përditshme. Narrativat e dezinformimit gjatë zgjedhjeve dhe politikës së përditshme konsiderohen praktikë

e zakonshme dhe shfrytëzojnë ndasitë shoqërore duke përdorur përmbajtjen digjitale si lëndë të parë. Ndër çështjet më të polarizuara shoqërore në Kosovë përfshihen dialogu me Serbinë, demarkacioni i kufirit me Malin e Zi dhe Gjykata e Dhomave të Specializuara. Kapaciteti institucional për të menaxhuar


dezinformimin e huaj është indikator më i cenueshëm në këtë domen, gjë që nënkupton kornizë ligjore dhe institucionale të dobët ose inekzistente. Kosova nuk ka asnjë politikë që të mbronte institucionet nga kërcënimet kibernetike, përkundër kërcënimeve të vazhdueshme kibernetike nga jashtë për vite me radhë.

Gjithsej pikë

45
/100

3 Gjetjet lidhur me domenin e perceptimit publik:

Indeksi zbulon se domeni i perceptimit publik është i cenuseshëm ndaj dezinformimit dhe ndikimeve malinj të huaja, duke shënuar 32 pikë nga 100 të mundshme.



Indikatorët zbulojnë dallime të mëdha në pikëpamjet ndërmjet etnive në popullsinë e Kosovës, ku qytetarët shqiptarë të Kosovës i shohin si më të favorshme NATO-n, SHBA-në, BE-në, ndërsa qytetarët serbë të Kosovës i shohin më pak të favorshme fuqitë perëndimore, ndërsa ndajnë opinion pozitiv për Rusinë dhe Kinën. Tri të katërtat e qytetarëve besojnë se ka

“lajme të rreme” (në gjuhën angleze, “fake news”) në media. Përkundër këtij niveli të ndërgjegjësimit, 41% e qytetarëve nuk bëjnë verifikimin e fakteve për informacionin që marrin, përkatësisht 28% i drejtohen familjes dhe miqve, ndërsa 13% kontrollojnë në rrjete sociale.³ Perceptimet e demokracisë në mesin e qytetarëve të Kosovës janë të cenuseshme, ku

Gjithsej pikë

32 /100

3 Sondazhi i opinionit publik nga NDI në Kosovë, prill 2022.

Implikimet për ndryshimet e politikave

Rritja e përdorimit të platformave digjitale duke përfshirë portalet online, në njërin anë, ka ndryshuar mënyrën e qasjes dhe komunikimit të informacionit nga aktorët shoqërorë të Kosovës, duke kontribuar në demokratizimin e këtij procesi. Në anën tjetër, të njëjtat mjete krijojnë mjedis të favorshëm për aktorët keqdashës të brendshëm dhe të huaj për të minuar vlerat demokratike përmes përhapjes së dezinformimit. Nëse dezinformimi nuk kontrollohet nga ata që janë të ekspozuar ndaj tij, çdo formë e tij mund të shkaktojë konfuzion publik, të intensifikojë polarizimin

politik, si dhe të dobësojë besimin në vlerat dhe sistemin demokratik.

Për më tepër, duke qenë pjesë e përditshme e hapësirës digjitale, në bazë ditore, qytetarët bombardohen me dezinformim për tema me rëndësi globale, duke përfshirë ndryshimet klimatike, barazinë gjinore, mjedisin, vlerat demokratike, etj. Kështu, dezinformimi vetëm sa po e përkeqëson mënyrën se si shoqëria i trajton këto sfida globale, duke i ekspozuar qytetarët ndaj informacioneve kontradiktore dhe lajthitëse.

Informacioni i saktë dhe i shëndoshë është parakusht për adresimin e këtyre sfidave globale; prandaj, adresimi i dezinformimit është domosdoshmëri urgjente për Kosovën.

Nuk ka një zgjidhje të vetme për dezinformimin, por, kundërpërgjigjet efektive ndaj tij do të duhej të kenë qasje shumëdimensionale përmes politikave, duke përfshirë ligjet dhe strategjitë, dhe veprimet e shoqërisë civile, ndër të tjera. Çfarë janë implikimet potenciale të kësaj analize?

→ **Së pari,** anëtarësimi i Kosovës në NATO dhe BE do t'i mundësonte Kosovës të forcojë reziliencën institucionale ndaj ndikimit malinj të huaj, i cili vjen nga Rusia, Kina, Serbia dhe gjatë.

→ **Së dyti,** futja e lëndës së edukimit mediatik në shkolla dhe universitete do t'u ofronte nxënësve dhe studentëve aftësi për të identifikuar çrregullimet e informacionit, si dhe do të kontribuojë në reziliencën më të madhe individuale ndaj dezinformimit dhe ndikimit malinj të huaj. Po ashtu, rritja e ndërgjegjësimit për çrregullimet e informacionit dhe mjetet për ta luftuar atë në radhët e grupeve që nuk janë të regjistruar në sistemin arsimor, janë thelbësore për një qasje institucionale gjithëpërfshirëse. Rezilienca individuale ka potencialin të formësojë pozitivisht hapësirën e informacionit dhe mediave.

→ **Së treti,** një kornizë ligjore e konsoliduar për sigurinë kibernetike do të hapte rrugën për krijimin e mekanizmave të qëndrueshëm institucionalë për të monitoruar dhe luftuar ndikimin malinj nga aktorët e huaj.

→ **Së katërti**, forcimi i kapaciteteve të organit vetërregullues të mediave online, Këshillit të Mediave të Shkruara në Kosovë, do të ndihmonte trajtimin më me kohë të të gjitha ankesave të pranuar dhe kryerjen e monitorimit proaktiv të mediave online. Ky i fundit shërben si mekanizëm mbrojtës në drejtim të parandalimit të përhapjes së dezinformimit.

→ **Së pesti**, bashkëpunimi dhe partneriteti ndërmjet sektorit privat, shoqërisë civile dhe institucioneve qeveritare dhe platformave digjitale do të përmirësonin reziliencën e hapësirës digjitale nga dezinformimi dhe ndikimi malinj i huaj. Në veçanti, këto partneritete do të shërbenin si mekanizma të rëndësishëm për identifikimin e çrregullimeve të informacionit; së këndejmi, do të ndihmonin parandalimin e përhapjes së dezinformimit nëpërmjet monitorimit dhe verifikimit të fakteve.

→ **Gjashtë**, integriteti i informacionit në Kosovë do të përfitonte nga zgjerimi i fushëveprimit të organizatave të shoqërisë civile për të përmirësuar mendimin kritik të qytetarëve, veçanërisht në mesin e të rinjve. Bashkëpunimi i tyre me mediat për të përmirësuar kapacitetet e gazetarëve për verifikimin e fakteve është gjithashtu i rëndësishëm.

Ky Indeks i Cenueshmërisë ndaj Dezinformimit u hartua nga Dr. Albana Rexha, analiste e lartë e politikave pranë Demokraci Plus me bazë në Kosovë; dhe Morgan Wack, kandidat për doktoraturë në Universitetin e Uashingtonit, i cili ndihmoi në zhvillimin e metodologjisë. Ky projekt u realizua nga Demokraci Plus (D+) dhe u mbështet nga Instituti Demokratik Kombëtar (NDI) dhe Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

1 Domeni i mjedisit mediatik

Gjithsej pikë

46 / 100

Indeksi zbulon se mjedisi mediatik është i cenueshëm ndaj dezinformimit dhe ndikimeve malinje të huaja, duke shënuar 46 pikë nga 100 të mundshme. Ky domen, duke qenë më i cenueshmi në mesin e tri domeneve të Indeksit, kap prevalencën dhe disponueshmërinë e dezinformimit në mediat kosovare, kapacitetin e institucioneve për të menaxhuar dezinformimin duke përfshirë mediat dhe rolin e Facebook-ut, si dhe reziliencën e publikut ndaj keqinformimit dhe dezinformimit. Në veçanti, në këtë domen përfshihen: (1) liria e mediave, (2) prevalenca/disponueshmëria e dezinformimit për publikun, (3) kapaciteti për të menaxhuar dezinformimin dhe (4) rezilienca e publikut ndaj keq/dezinformimit.

Së pari, kapaciteti për të menaxhuar keq/dezinformimin është i cenueshëm, duke shënuar 59 pikë nga 100 të mundshme.

Sipas mendimit të ekspertëve, kapaciteti i institucioneve, në veçanti i mediave, për të menaxhuar kërcënimin nga dezinformimi perceptohet i ulët. Në mënyrë të ngjashme, efektiviteti i Facebook-ut për të kontrolluar dezinformimin konsiderohet i dobët/inekzistent, kryesisht për shkak të mungesës së një partneri për verifikimin e fakteve në Kosovë, deri së voni. Aktualisht, ka 1.1 milion përdorues të mediave sociale, ku Facebook është platforma më e madhe që përdoret në vend.⁴ Duke filluar nga qershori 2022, Meta filloi programin e saj lokal të verifikimit të fakteve nga palët e treta në Kosovë – Krypometri.⁵ Sipas këtij njoftimi, ky program do të përmirësojë cilësinë e postimeve në News Feed, ku Facebook do të heqë llogaritë dhe përmbajtjet që shkelin standardet e tij të komunikimit apo politikën e marketingut. Për më tepër, ndërkohë që shkalla e lartë e depërtimit të internetit në Kosovë është e dobishme për qytetarët, interneti mund të shërbejë edhe si mjet për përhapjen e dezinformimit. Ekzistojnë vetëm disa portale të pavarura të verifikimit të fakteve në vend, në pronësi të organizatave vendase të shoqërisë civile, ku përgënjeshtrohen informacionet.⁶

Së dyti, prevalenca dhe disponueshmëria e dezinformimit për publikun përmes platformave digjitale është çështje serioze në mbarë Kosovën. Indeksi e zbulon këtë indikator si të cenueshëm, duke shënuar 47 pikë nga 100 të mundshme. Sipas mendimit të ekspertëve, dezinformimi konsiderohet kërcënim më serioz në hapësirën digjitale në krahasim me mediat tradicionale, duke përfshirë kanalet televizive publike dhe private. Në mbështetje të opinionit të këtyre ekspertëve janë edhe të dhënat e sondazhit nga NDI që nxjerr në pah se televizionet tradicionale janë burimi më i besueshëm i informacionit.⁷ Në përgjithësi, përhapja e shpejtë e platformave online dhe mungesa e kapaciteteve institucionale e ka bërë më të vështirë garantimin e sigurisë së përdoruesve online. Mediat online vetërregullohen përmes Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës.⁸ Megjithatë, kapacitetet e Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës për të kryer monitorimin ex-ante të përmbajtjes online dhe për të shqyrtuar të gjitha ankesat e pranuar janë të mangëta. Për më tepër, Këshilli nuk ka kompetenca detyruese lidhur me vendimet e tij; së këndejmi, funksionaliteti i tij është i kufizuar.

⁴ Raport nga NDI. (2022). "Information Integrity in Kosovo: Assessment of the Political Economy of Disinformation". Në dispozicion këtu <https://www.ndi.org/publications/information-integrity-kosovo-assessment-political-economy-disinformation>

⁵ Kallxo.com. (2022) "Krypometri do të verifikojë faktet e publikimeve në Facebook dhe Instagram". Artikull në media online. Në dispozicion këtu <https://kallxo.com/gjate/krypometri-do-te-verifikoj-faktet-e-publikimeve-ne-facebook-dhe-instagram/>

⁶ Në këto portale përfshihen hybrid.info dhe kryptometri. Ky i fundit i lejon qytetarët t'i informojnë ata për çdo histori që duan të verifikohet duke vënë etiketën (në gjuhën angleze, tag) kryptometri në Facebook dhe Twitter.

⁷ Anketa e Opinioneve Publik në Kosovë nga NDI, Prill 2021

⁸ Për më shumë informacion, shih uebsajtin e Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës <https://presscouncil-ks.org/>

Mjedisi mediatik përkeqësohet gjatë ngjarjeve polarizuese, veçanërisht gjatë zgjedhjeve, pasi individë që ndjekin agjenda specifike blejnë domenet në platformat digjitale për të shpërndarë keq/dezinformimin.⁹ Nisur nga ky kontekst, përhapja e dezinformimit bëhet më e lehtë. Së treti, sistemi arsimor nuk i përgatit qytetarët kosovarë për të identifikuar çrregullimet

e informacionit; së këndejmi, ai kontribuon në reziliencën e dobët të publikut ndaj keqinformimit/dezinformimit.¹⁰ Indeksi e zbulon këtë indikator si të cenueshëm, duke shënuar 45 pikë nga 100 të mundshme. As nxënësve të të gjitha moshave, as studentëve (përveç studentëve të gazetarisë), nuk u ofrohet asnjë lëndë mësimore e edukimit mediatik.¹¹ Është e

rëndësishme të theksohet se Programi i OECD-së për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA), i cili vlerëson aftësinë e 15-vjeçarëve për të lexuar, njohuritë dhe aftësitë e matematikës dhe shkencës për t'i dalë mbanë sfidave të jetës reale ndër të tjera, renditi nxënësit 15-vjeçarë në Kosovë në nivelin më të ulët në rajon.¹²

9 Intervistë me Getoarbë Mulliqin. Drejtore e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës. 29 qershor 2022.

10 Të gjithë ekspertët e intervistuar.

11 Intervistë me Dren Gërgurin, profesor asistent në Universitetin e Prishtinës. 23 maj 2022.

12 OECD, Rezultatet e PISA-s për 2018. Në dispozicion këtu <https://www.oecd.org/pisa/publications/pisa-2018-results.html>

2 Domeni i peizazhit politik

Gjithsej pikë

44.75 / 100

Indeksi zbulon se peizazhi politik është i cenueshëm ndaj dezinformimit dhe ndikimeve malinje të huaja, duke shënuar 44.75 pikë nga 100 të mundshme. Ky domen kap qëndrimet dhe sjelljet e udhëheqësve institucionalë (presidentes, kryetarit të kuvendit dhe kryeministrit), kapacitetin institucional, cenueshmërinë gjatë politikës së përditshme dhe zgjedhjeve, si dhe kapacitetin institucional për të menaxhuar dezinformimin e huaj. Në këtë domen përfshihen katër indikatorë: (1) qëndrimet dhe sjelljet e udhëheqësve politikë, (2) kapaciteti institucional, (3) cenueshmëria gjatë politikës së përditshme/zgjedhjeve dhe (4) kapaciteti institucional për të menaxhuar dezinformimin e huaj.

Së pari, kërcënimi nga ndikimi malinj i huaj konsiderohet sfidë madhore me të cilën përballen institucionet e Kosovës dhe demokracia në përgjithësi.¹³

Kapaciteti institucional për të menaxhuar dezinformimin e huaj është indikatori më i cenueshëm në domenin e peizazhit politik, duke shënuar 61 nga 100 pikë të mundshme; së këndejmi, ai tregon se korniza ligjore/institucionale është e dobët ose mungon. Në mënyrë të ngjashme, nëse do të shtoheshin përpjekjet malinje të huaja për të destabilizuar Kosovën, kapaciteti institucional për t'iu kundërpërgjigjur perceptohet si i ulët.¹⁴

Së dyti, indikatori i cenueshmërisë gjatë politikës së përditshme/zgjedhjeve shënon 49 pikë nga 100 të mundshme. Narrativat e dezinformimit gjatë zgjedhjeve dhe politikës së përditshme janë praktikë e zakonshme.¹⁵ Shumica e narrativave të dezinformimit në Kosovë shfrytëzojnë ndasitë shoqërore duke përdorur përmbajtjen digjitale si lëndë të parë. Ndër çështjet më të polarizuara shoqërore në Kosovë përfshihen dialogu me Serbinë dhe demarkacioni i kufirit me Malin e Zi.¹⁶ Të dhënat e monitorimit nga organizatat e shoqërisë civile tregojnë se rreth këtyre çështjeve janë përhapur sasi të mëdha të dezinformimit në hapësirën digjitale.¹⁷ Për më tepër, shumë dezinformata janë është përhapur

edhe për themelimin e Gjykatës së Dhomave të Specializuara, çështje për të cilën shoqëria ka pikëpamje tejet të polarizuara, duke ofruar sërish lëndë të parë të bollshme për dezinformim për këtë çështje "polemizuese" (në gjuhën angleze "hot-button issue") kur tashmë ka opinione shumë të ndara brenda shoqërisë.

Së treti, indikatori i qëndrimeve dhe i sjelljes së udhëheqësve politikë është i cenueshëm, me 35 pikë nga 100 të mundshme; por, është e rëndësishme të theksohet se është më pak i cenueshëm kur krahasohet me kapacitetin institucional për të menaxhuar dezinformimin e huaj dhe cenueshmërinë gjatë zgjedhjeve dhe politikës së përditshme. Ky indikator vlerëson qëndrimet e udhëheqësve politikë ndaj SHBA-së, NATO-s, BE-së, Kinës, Rusisë dhe Serbisë, dhe masën në të cilën veprimet dhe deklaratat e tyre i kanë përmbushur normat demokratike. Analiza nxjerr në pah marrëdhëniet më të brishta të udhëheqësve politik kosovar me Serbinë, pasuar nga Rusia dhe Kina dhe më pak të brishta me SHBA-në, pasuar nga ato me BE-në dhe NATO-n.

13 Të gjithë ekspertët e intervistuar për këtë Indeks (shih listën e ekspertëve të intervistuar) ishin të pajtimit se dezinformimi i huaj është kërcënim madhor për demokracinë e Kosovës.

14 Po aty.

15 Të katërmbëdhjetë (14) ekspertët e intervistuar.

16 Po aty.

17 D4D (2022). "Informacioni i çrregullt: Ndikimi i tij tek informimi i qytetarëve", Raport monitorimi.

3 Domeni i perceptimit publik

Gjithsej pikë

31.75 /100

Indeksi zbulon se domeni i perceptimit publik

është i cenueshëm ndaj dezinformimit dhe ndikimeve malinje të huaja, duke shënuar 31.75 pikë nga 100 të mundshme. Ky domen kap pikëpamjet e qytetarëve të Kosovës në lidhje me marrëdhëniet e Kosovës me vendet e tjera, besimin e tyre në demokraci dhe aftësinë e tyre për të dalluar informacionin e besueshëm nga keqinformimi dhe dezinformimi. Ai përfshin katër indikatorë konkretë si vijon: (1) pikëpamjet e popullsisë kosovare në lidhje me NATO-n, SHBA-në, BE-në, Rusinë dhe Kinën; (2) besimi në teoritë e konspiracionit dhe dezinformim; (3) perceptimet e demokracisë; dhe (4) besimi në institucione. Burimet e përdorura në këtë domen përfshijnë të dhënat nga sondazhet e zhvilluara nga NDI në nivel kombëtar dhe rajonal. Grafiku i mësipërm tregon rezultatin e përgjithshëm për secilin indikator, megjithëse është e rëndësishme të kuptohet se zbërthimi i të dhënave sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike luan rol të ndjeshëm në përgatitjen

e politikave më të synuara. Kjo bëhet edhe më e rëndësishme në kontekstin e shoqërisë shumetnike të Kosovës; së këndejmi, në seksionin e mëposhtëm, secili indikator diskutohet duke marrë parasysh zbërthimin e të dhënave sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike.

Së pari, indikator i pikëpamjet e popullsisë kosovare për NATO-n, SHBA-në, BE-në, Kinën dhe Rusinë është më pak i cenueshëm, me 27 pikë nga 100 të mundshme. Por, zbërthimi i të dhënave sipas përkatësisë etnike shpërfaq dallime të mëdha në pikëpamje; qytetarët shqiptarë të Kosovës kanë pikëpamje më të favorshme për NATO-n, SHBA-në, BE-në dhe shumica e tyre do të votonin pro në referendumin për anëtarësim në BE dhe NATO, ndërsa qytetarët serbë të Kosovës kanë pikëpamje më pak të favorshme për fuqitë perëndimore dhe shumica e tyre nuk do të votonin për anëtarësim as në BE, as në NATO. Ndryshe nga shqiptarët e Kosovës, opinioni i serbëve të Kosovës për Rusinë dhe Kinën është pozitiv. Ky rezultat, duke pasur parasysh nivelin e cenueshmërisë ndaj dezinformimit, është dukshëm më i lartë në mesin e komunitetit serb të Kosovës në krahasim me komunitetin shqiptar të Kosovës. Për më tepër, zbërthimi i të dhënave sipas gjinisë nuk zbulon

dallime në pikëpamjet dhe votat e grave dhe burrave për këtë indikator.

Së dyti, indikator i besimit në teoritë e konspiracionit dhe dezinformimit zbulon se qytetarët janë më pak të cenueshëm, duke shënuar 24 pikë nga 100 të mundshme. Ky rezultat tregon se tri të katërtat e qytetarëve besojnë se në media ka lajme të rreme dhe ata mund të identifikonin teoritë e konspiracionit lidhur me COVID-19. Përkundër këtij niveli të ndërgjegjësimit, 41% e qytetarëve nuk bëjnë verifikimin e fakteve për informacionin që marrin, përkatësisht 28% i drejtohen familjes dhe miqve dhe 13% kontrollojnë në rrjetet sociale.¹⁸ Zbërthimi i të dhënave sipas përkatësisë etnike paraqet dallime të vogla ndërmjet shqiptarëve të Kosovës, serbëve të Kosovës dhe komuniteteve të tjera (boshnjak, goran, turk, rom, ashkali dhe egjiptian). Grupi më pak i cenueshëm i qytetarëve i takon komunitetit serb të Kosovës (22/100), pasuar nga komuniteti shqiptar (25/100) dhe komunitetet tjera (29/100). Dallimet në besimet ndërmjet burrave dhe grave gjithashtu nuk janë të mëdha; rezultati i respondentëve në mesin e grave është 25/100, ndërsa për respondentët në radhët e burrave është 23/100.

Së treti, perceptimet e demokracisë në mesin e qytetarëve të Kosovës janë të cenueshme, duke shënuar 37 pikë nga 100 të mundshme. Sondazhet tregojnë se kosovarët kanë shkallë të lartë të mbështetjes për demokracinë në përgjithësi.¹⁹ Por, zbërthimi i të dhënave sipas përkatësisë etnike zbulon dallime të vogla ndërmjet etnive. Etnitë tjera (boshnjakët, goranët, turqit, romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët) kanë perceptime më të mira për demokracinë (34/100), pasuar nga shqiptarët e Kosovës (38/100) dhe serbët e Kosovës (43/100). Ky rezultat është në përputhje me pikëpamjet e favorshme të serbëve të Kosovës për Rusinë dhe Kinën në krahasim me fuqitë perëndimore. Nga ana tjetër, të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë shpërfaqin perceptime të ngjashme të demokracisë midis grave (38/100) dhe burrave (37/100) të të gjitha komuniteteve që jetojnë në vend.

Së katërti, indikator i besimit në institucione zbulon se qytetarët janë të cenueshëm, duke shënuar 39 pikë nga 100 të mundshme. Ky indikator mat pikëpamjet e qytetarëve ndaj institucioneve, duke përfshirë presidenten, kuvendin, qeverinë, kryeministrin, policinë, mediat, shoqërinë civile, partitë politike, ushtrinë, gjyqësorin dhe institucionet

e pavarura. Nuk ka dallime të mëdha ndërmjet grave dhe burrave të të gjitha komuniteteve.

Megjithatë, zbërthimi i të dhënave sipas përkatësisë etnike zbulon dallime të mëdha ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe komuniteteve të tjera (boshnjak, goran, turk, rom, ashkali dhe egjiptian), në njërin anë dhe komunitetit serb të Kosovës, në anën tjetër. Besimi në institucione në mesin e qytetarëve serbë të Kosovës (66/100) është përgjysmë më pak në krahasim me besimin në institucionet në mesin e qytetarëve shqiptarë të Kosovës (38/100) dhe qytetarëve të komuniteteve të tjera (37/100). Këto rezultate janë në përputhje me besimin më të ulët në institucionet që kanë qytetarët serbë të Kosovës dhe pikëpamjet e tyre të favorshme ndaj Rusisë dhe Kinës në krahasim me SHBA-në, NATO-n dhe BE-në.

Në përgjithësi, Indeksi zbulon perceptimin e publikut si të cenueshëm ndaj dezinformimit dhe ndikimeve malinje të huaja. Së pari, të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë dallime të mëdha në pikëpamjet ndaj fuqive perëndimore, nga njëra anë, dhe Rusisë dhe Kinës, nga ana tjetër. Këto dallime qëndrojnë kryesisht në mes të komunitetit shqiptar të Kosovës dhe komuniteteve të tjera kundrejt

komunitetit serb të Kosovës që jeton në vend. Së këndejmi, analiza nënkupton se komuniteti serb i Kosovës që jeton në vend është më i cenueshëm ndaj dezinformimit, në krahasim me komunitetin shqiptar të Kosovës dhe komunitetet tjera. Dy faktorë kryesorë shpjegues që qëndrojnë prapa kësaj janë gjuha serbe dhe lidhja kulturore ndërmjet serbëve dhe rusëve. Së dyti, të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë në të gjithë indikatorët e këtij domeni nuk tregojnë ndonjë dallim të madh ndërmjet grave dhe burrave.

¹⁸ Raport nga NDI. (2022). "Information Integrity in Kosovo: Assessment of the Political Economy of Disinformation". Në dispozicion këtu <https://www.ndi.org/publications/information-integrity-kosovo-assessment-political-economy-disinformation>

¹⁹ Sondazhi i Opinioneve Publik nga NDI më 2019 dhe 2021.

Sfidat e integritetit të informacionit në Kosovë

Është shumë alarmante “që vendet e aderimit në BE në Ballkanin Perëndimor po goditen veçanërisht rëndë nga ndërhyrjet dhe fushatat e dezinformimit të huaj me origjinë nga Rusia dhe Kina...”

(Rezolutë e Parlamentit Evropian, 6 korrik 2022).²⁰

Dezinformimi, i kuptuar si shpërndarja e qëllimshme e informacionit të rremë, po përhapet në mbarë botën dhe po bëhet dukuri më komplekse. Në një demokraci funksionale, informacioni i besueshëm luan rol kyç në transparencën e qeverisë, kështu që çdo mungesë e integritetit të informacionit kërcënon aftësinë e qytetarëve për të monitoruar veprimet e qeverisë dhe për të kërkuar llogari nga qeveria e tyre. Në këtë drejtim, shtimi i dezinformimit në mesin e banorëve të një komuniteti mund të mbjellë konfuzion, ndërkohë që rrezikon sigurinë e atij komuniteti të caktuar, por edhe më gjerë.

Rritja e përdorimit të platformave digjitale dhe pandemia shkatërruese e COVID-19 kanë përshpejtuar përhapjen e dezinformimit duke kaluar kufijtë e vendeve. Një sërë studimesh akademike dhe të politikave kanë analizuar këtë shqetësim madhor dhe ndikimin e tij në demokracinë dhe sigurinë kombëtare në mbarë botën, si dhe përpjekjet për të krijuar një epokë të

“pas të vërtetës” në lidhje me shëndetin publik gjatë pandemisë.²¹

Dy nga shembujt më të fundit të përhapjes intensive në mbarë botën të dezinformimit në platformat digjitale lidhen me pandeminë dhe luftën në Ukrainë. Gjatë periudhës së ngujimit mars-prill 2020, njerëzit nuk ishin në gjendje të lëviznin lirshëm; së këndejmi, ata përdorën më shpesh internetin për të gjetur dhe ndarë informacione rreth pandemisë që çuan në më shumë se 500 milionë cicërime dhe tejkaluan, me marzhë të madhe, lajmet e tjera përkatëse në Google.²² Pjesa më e madhe e informacionit të shpërndarë ishte informacion lajthitës, i anshëm dhe jo i besueshëm. Kështu, një numër i vendimmarrësve të profilit të lartë, duke përfshirë presidenten e Komisionit Evropian Ursula Von Der Leyen, pranuan praninë e dezinformimit të tillë, ndërsa ajo iu drejtua përdoruesve të mediave sociale përmes videos duke deklaruar “... Jam e brengosur se ata që qëndrojnë prapa këtyre pretendimeve

po shfrytëzojnë frikën e njerëzve për virusin vetëm për të fituar para...”

²³. Kjo video, në mesin e shumë videove dhe komunikatave të tjera për shtyp të figurave publike, ishte tentativë nga nivelet më të larta të vendimmarrjes së BE-së për të përgënjeshtuar keqinformimin dhe dezinformimin lidhur me COVID-19 dhe vaksinat.

Për më tepër, dezinformimi është përdorur nga qeveria ruse si mjet në sulmin ndaj Ukrainës,²⁴ si dhe në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Rusia ka përdorur një strategji të larmishme për të futur dhe përhapur narrativa të rreme dhe të shtrembëruara në të gjithë botën, ndërsa përdor llogari të rreme dhe uebsajte anonime për të çuar përpara interesat e veta shtetërore.

Fatkeqësisht, dezinformimi vazhdon të jetë shumë i përhapur në shumë vende dhe motivi prapa përhapjes së shpejtë të tij është shpesh i natyrës politike dhe/ose ekonomike. Së pari, dezinformimi mund të ndodhë përmes ndikimit malinj të huaj (aktori apo aktorët e huaj shtypin agjendat e brendshme). Fushatat e dezinformimit nga aktorë malinj të huaj vazhdojnë të kërcënojnë demokracitë e zhvilluara, siç është vërejtur nga presidenti i SHBA-së, Biden:

“Rusia ka funksionalizuar konceptin e konkurrencës së përhershme kundërshtare në mjedisin e informacionit duke inkurajuar zhvillimin e ekosistemit të dezinformimit dhe propagandës”.²⁵

Së dyti, dezinformimi mund të ndodhë në nivel të brendshëm nga një aktor i brendshëm me qëllim që të minojë kundërshtarët politikë dhe/ose të shtyjë agjenda specifike (aktorët e brendshëm për audiencën e brendshme). Së treti, dezinformimi mund të përhapet me qëllimin e vetëm për të realizuar fitim; kjo kategori njihet si dezinformimi fitimprurës.²⁶ Një shembull i kohëve të fundit i kësaj forme dezinformimi lidhet me vaksinat, në veçanti, përhapja e dezinformimit se njëra vaksinë është më e mirë se tjetra për sa i përket shkaktimit të pasojave më pak negative shëndetësore. Së katërti, dezinformimi mund të ndodhë edhe për t'i shërbyer qëllimeve ideologjike të grupeve të veçanta.

Asnjë vend nuk është imun ndaj dezinformimit të çfarëdo forme, dhe Kosova nuk bën përjashtim; së këndejmi, kundërpërgjigjet efektive janë çelësi për adresimin dhe luftimin e tij. Kosova është subjekt i dezinformimit nga aktorë malinj të huaj si Rusia, Kina dhe agjenti i Rusisë në rajon, Serbia²⁷ Parlamenti Evropian gjithashtu thekson se Kosova është subjekt i fushatave të dezinformimit dhe aktiviteteve hibride malinje të huaja, veçanërisht atyre nga Rusia dhe Kina, që synojnë të dobësojnë perspektivën e rajonit për anëtarësim në BE, përfshirë Kosovën.²⁸ Deri më tani, dezinformimi është pranuar si sfidë themelore për demokracinë dhe sigurinë tonë kombëtare.²⁹

Mirëpo, as institucionet e Kosovës, as aktorët e tjerë shoqërorë nuk kanë bërë ndonjë analizë të situatës për të vlerësuar nivelin e cenueshmërisë ndaj dezinformimit. Së këndejmi, hapi i parë drejt mbrojtjes së institucioneve dhe shoqërisë së vendit nga dezinformimi dhe ndikimi malinj i huaj do të duhej të jetë vlerësimi i situatës aktuale dhe identifikimi i domeneve ku vendi është më i cenueshëm. Kjo do të ofrojë të dhëna dhe informacion për aktorët përgjegjës qeveritarë në mënyrë që të përgatisin ndërhyrje të bazuara në fakte për t'i luftuar këto. Prandaj, Demokraci Plus (D+), me mbështetje nga NDI në

20 Rezolutë e Parlamentit Evropian, datë 6 korrik 2022, Për Raportin e Komisionit për Kosovën për vitin 2021. Neni 41. Në dispozicion këtu https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-9-2022-0285_EN.html

21 Das., R. and Ahmed., W. (2021). “Rethinking Fake News: Disinformation and Ideology during the time of COVID-19 Global Pandemic”. SAGE Journal Publishing. Colomina, C., Sanchez Margalef., and Youngs., R. (2021). “The impact of disinformation on democratic processes and human right in the world”. Directorate- General for External Policies. Policy Department. European Parliament.

Sarts., J. (2020). “Disinformation as a Threat to National Security” Springer Link. Në dispozicion këtu https://link.springer.com/chapter/10.1007/978-981-15-5876-4_2

McKay., S. and Tenove., Ch. (2020) “Disinformation as a Threat to Deliberative Democracy” Political Research Quarterly. Sage Journal. Available at <https://journals.sagepub.com/doi/abs/10.1177/1065912920938143>

Tenove., Ch. (2020). “Protecting Democracy from Disinformation: Normative Threats and Policy Responses” The International Journal of Press/Politics. Available at <https://journals.sagepub.com/doi/abs/10.1177/1940161220918740>

22 Wang, X., Zhang, M., Fan, W., and Zhao, K., (2022). “Understanding the spread of COVID-19 misinformation on social media: The effects of topics and a political leader’s nudge” Journal Association Information Technology.

23 COVID-19: President von der Leyen on disinformation. 31 March 2020. Në dispozicion këtu <https://www.youtube.com/watch?v=jZooWOdU1xg>

24 OECD (2022). “Policy Responses: Ukraine Tackling the Policy Challenges” Policy Paper. Në dispozicion këtu <https://www.oecd.org/ukraine-hub/policy-responses/disinformation-and-russia-s-war-of-aggression-against-ukraine-37186bde/>

25 Departamenti Amerikan i Shtetit. Çarmatosja e dezinformimit: Përgjegjësia jonë e përbashkët. Komunikatë për shtyp. Në dispozicion këtu <https://www.state.gov/disarming-disinformation/>

26 Dezinformimi fitimprurës i referohet dezinformimit për përfitime financiare.

27 Intervistë me Përparim Krjeziun. Zëdhënës i Qeverisë. 19 gusht 2022.

28 Rezoluta e Parlamentit Evropian, datë 6 korrik 2022, Për Raportin e Komisionit për Kosovën për vitin 2021. Neni 43. Në dispozicion këtu https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-9-2022-0285_EN.html

29 Intervistë me Ehat Miftarajn. Drejtor i Institutit të Kosovës për Drejtësi. 16 maj 2022.

Intervistë me Demush Shashën. Drejtori i Institutit EPIK. 23 maj 2022.

Intervistë me Shpat Balajn. Hulumtues në QKSS. 31 maj 2022.

Intervistë me Blerim Rexhën. Profesor në Universitetin e Prishtinës 25 maj 2022.

Intervistë me Dren Gërgurin, profesor asistent në Universitetin e Prishtinës. 23 maj 2022.

Kosovë, ka përgatitur këtë Indeks të Cenueshmërisë ndaj Dezinformimit. Është e rëndësishme të përmendet se NDI është një nga partnerët e jashtëm më të rëndësishëm të qeverisë për të vlerësuar, diskutuar dhe luftuar dezinformimin, nëpërmjet Forumit të Integritetit të Informacionit.³⁰

Ky Indeks ofron një pamje gjithëpërfshirëse të nivelit të cenueshmërisë për tri domene: perceptimin publik, peizazhin politik dhe mjedisin mediatic. Seksioni i mëposhtëm diskuton gjetjet kryesore, pasuar nga analiza për secilën fushë veç e veç.

Shpresojmë që Indeksi i Cenueshmërisë ndaj Dezinformimit në Kosovë do të stimulojë qeverinë që t'i japë prioritet nevojës për të monitoruar dhe luftuar çdo formë të dezinformimit, duke mbrojtur kështu demokracinë dhe sigurinë kombëtare të vendit tonë.

Sfida kritike e sigurisë kibernetike.

Institucionet e Kosovës janë përballur herë pas here me sulme kibernetike, që përbëjnë sfidat më kritike për sistemet tona të komunikimit dhe informacionit. Sulmet më të fundit kibernetike që kishin në shënjestër institucionet e Kosovës ndodhën gjatë

javës së parë të shtatorit 2022 dhe origjinën e kishin jashtë vendit.³¹ Gjatë kësaj kohe, vendet fqinje, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, u përballën gjithashtu me sulme kibernetike ndaj sistemeve të tyre të informacionit.³² Ndërkohë, Qeveria e Kosovës është në proces të konsultimeve publike për projektligjin për sigurinë kibernetike, sipas të cilit do të themelohet Agjencia e Sigurisë Kibernetike. Aktualisht, ky projektligj është në fazën e konsultimeve publike.³³ Mirëpo, siguria kibernetike nuk u përfshi si pjesë e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të sapo adoptuar (2022-2027).³⁴ Në këtë të fundit, termi siguri kibernetike përmendet vetëm një herë si pjesë e seksionit që mbulon transformimin digjital. Në përgjithësi, mungon një politikë e konsoliduar për sigurinë kibernetike. Për më tepër, nuk ka mekanizma të qëndrueshëm institucionale për të monitoruar dhe luftuar dezinformimin, përkundrazi ekzistojnë vetëm mekanizma ad hoc të krijuar në varësi nga situata e riskut (p.sh., në bazë ad hoc).³⁵

Ndikimi malinj i huaj nga Rusia.

Vendimi i qeverisë për reciprocitetin e targave të automjeteve më 20 shtator 2021³⁶ ofron një shembull evident të ndikimit që mund të ketë ndikimi malinj i huaj në sigurinë kombëtare të

Kosovës. Pas këtij vendimi për targat e automjeteve, në komunat veriore u përhapën propagandë, dezinformim dhe lajme të rreme nga Serbia me qëllim përshkallëzimin e situatës në terren, në komunitetet me shumicë serbe, duke nxitur frikën se Forca e Sigurisë së Kosovës do të hynte në këto zona me shumicë serbe. Megjithatë, qeveria, në koordinim të ngushtë me aleatët ndërkombëtarë, koordinoi me sukses të gjithë mekanizmat e sigurisë kombëtare, duke parandaluar përshkallëzimin e situatës në terren. Sipas një organizate që monitoron portalet online, ky vendim i qeverisë u ndoq me vëllimin më të madh të dezinformimit dhe keqinformimit në hapësirën digjitale gjatë vitit.³⁷ Për më tepër, institucione të ndryshme qeveritare përgënjeshtuan dezinformimin e tillë duke lëshuar komunikata për shtyp dhe duke theksuar se Forca e Sigurisë së Kosovës nuk kishte qëllim të ndërhyjë në veri.³⁸ Por, ky mbetet shembull i fortë se sa i rrezikshëm mund të jetë dezinformimi malinj i huaj nga Rusia dhe Serbia për sigurinë kombëtare të Kosovës dhe shquan nevojën për të pasur mekanizma të konsoliduar kundër dezinformimit.

Për më tepër, ky Indeks zbulon se faktorët kryesorë mjedisorë që

mundësojnë dezinformimin dhe ndikimin malinj të huaj përfshijnë partinë politike Lista Serbe, institucionet jo të forta, polarizimin shoqëror për çështjet e dialogut me Serbinë dhe Gjykatën Speciale, ndër të tjera. Sipas drejtoreshës së Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, mungesa e bashkëpunimit të qeverisë me gazetarët shërben si një faktor tjetër i rëndësishëm që mundëson përhapjen më të lehtë të dezinformimit të huaj përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit, kryesisht përmes mediave sociale.³⁹ Në përgjithësi, dezinformimi prodhohet në lidhje me tema që kanë natyrë përçarëse dhe për të cilat ka kërkesë shoqërore. Këto përfshijnë kryesisht çështje të natyrës politike, siç është dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe Gjykata e Dhomave të Specializuara.⁴⁰

Kosova mbetet e palëkundur në mbështetje të perëndimit.

Është e rëndësishme të theksohet se Indeksi zbulon se nuk ka dëshmi se Kosova ka pësuar ndryshime në politikën e saj të orientimit pro-perëndimor, që do të thotë se peizazhi politik nuk ka qenë i cenueshëm në orientimin strategjik të tij. Gjithashtu, Sondazhi i Opinioneve Publik nga NDI (2021) tregon se pikëpamjet e favorshme të publikut të Kosovës për SHBA-në, NATO-n, BE-në janë konsistente, por janë në rënie në favor të Kinës dhe Rusisë në krahasim me vitet e kalu-

ara.⁴¹ Por, të dhënat e zberthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë se ka lidhje të fortë me dallimet etnike; d.m.th., ata që favorizojnë fuqitë perëndimore janë përgjithësisht shqiptarë të Kosovës, ndërsa ata që favorizojnë Kinën dhe Rusinë janë përgjithësisht serbë të Kosovës.

Shkalla e lartë e depërtimit të internetit në Kosovë.

Për më tepër, një faktor i rëndësishëm që lehtëson depërtimin e dezinformimit dhe keqinformimit është tregu i mbipopulluar i mediave online në Kosovë. Mjedi i mediave online përballet me sfida për sa i përket qëndrueshmërisë financiare, transparencës dhe pavarësisë, duke u shndërruar kështu në terren të favorshëm për shumimin dhe përhapjen e dezinformimit, keqinformimit dhe gjuhës nxitëse.⁴² Ato vetërregullohen përmes Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës; megjithatë, kapacitetet e shtypit për të kryer monitorimin ex-ante të përmbajtjes online dhe për të shqyrtuar të gjitha ankesat e pranuar janë të mangëta. Të dhënat e anketës së zhvilluar nga NDI, të cilat tregojnë se 38% e qytetarëve të Kosovës besojnë se në internet publikohen lajme të rreme për interesa financiare ose përfitime të mundshme financiare, e mbështesin këtë gjetje.⁴³ Mungesa e transparencës dhe pavarësisë financiare të mediave mund të dëmtojë opinionin

publik, pjesëmarrjen politike të qytetarëve dhe vendimmarrjen.

Për më tepër, ndërkohë që shkalla e lartë e depërtimit të internetit në Kosovë është e dobishme për qytetarët, interneti mund të shërbejë edhe si mjet për përhapjen e dezinformimit. Të dhënat nga NDI tregojnë se ka 1.1 milionë përdorues të mediave sociale në vend, ku Facebook është platforma më e madhe.⁴⁴ Më saktë, Kosova ka më së shumti përdorues të Facebook-ut për frymë në Evropë.⁴⁵ Mirëpo, Meta nuk kishte program për verifikimin e fakteve nga palët e treta në Kosovë deri në mesin e vitit 2022, por përkundrazi punoi përmes verifikuesve të tjerë të fakteve në gjuhën shqipe nga Ballkani Perëndimor. Duke filluar nga qershori i vitit 2022, Meta angazhoi një partner lokal për verifikimin e fakteve në Kosovë për të identifikuar dezinformimin dhe për të hequr çdo informacion që shkel standardet e komunikimit.⁴⁶ Në kuadër të këtij partneriteti, nga korriku deri në tetor 2022, Krypometri përgënjeshtroi 206 artikuj që u shpërndanë në mbi 600 postime në Facebook.⁴⁷ Prandaj, roli i Facebook-ut është i jashtëzakonshëm në drejtim të parandalimit të përhapjes së keq/dezinformimit; së këndejmi, partneritetet me platforma të tjera digjitale janë domosdoshmëri në këtë luftë kundër ndikimit malinj të huaj dhe dezinformimit

30 Intervistë me Përparim Kryeziun. Zëdhënës i Qeverisë. 19 gusht 2022

Forumi i Integritetit të Informacionit synon të lehtësojë dialogun e brendshëm ndërmjet palëve kyçe të interesit për çështjet që duhet të trajtohen. Përmes diskutimeve dhe dialogut konstruktiv që do të jenë pikënisja e këtij forumi, NDI synon të iniciojë bisedime për zgjidhjet e mundshme për problemet e mjedisit mediatic në Kosovë.

31 Epoka e Re. (2022). Artikulli i mediave online. Në dispozicion këtu <https://www.epokaere.com/sulm-kibernetik-ndaj-institucioneve-te-kosoves/>

32 Euronews Albania. Në dispozicion këtu <https://www.youtube.com/watch?v=in7U134m98I>

33 Platforma e Konsultimeve Publike. Projektligji për Sigurinë Kibernetike. Në dispozicion këtu <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=40905>. Note: The draft-law at the time of INDEX publication might be at a different phase of lawmaking.

